

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE, SHOQËRISË

“HIDRO VIZION” SHPK TIRANË

Për ushtrimin financiar të mbyllur më 31 Dhjetor 2022

TË PËRGJITHËSHME DHE POLITIKAT KONTABEL

Shoqëria “HIDRO VIZION” SHPK, u regjistrua si biznes në datë 03/06/2016 me administrator Z. Daniel Shuaipi, me objekt veprimtarie: Financimin, projektimin, ndertimin, venien në punë, administrimin, mirembajtjen e hidrocentralit "Razdoll" dhe transferimin e tij në perfundim të kontratës tek Autoriteti Kontraktues si dhe prodhimin, furnizimin, transmetimin, shpërndarjen, eksportimin dhe shitjen e energjise elektrike, në zbatim të Kontrates së Koncesionit që do të lidhet me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë"

Kjo shoqëri është regjistruar pranë organeve tatimore me NIPT: L61803020D.

MBI POLITIKAT KRYESORE TË KONTABILITETIT

Pasqyrat financiare më 31 Dhjetor 2022 janë përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit 9901 të datës 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare” si dhe të ligjit 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin e pasqyrat financiare”

Kontabiliteti i shoqërisë “HIDRO VIZION” SHPK, është i organizuar rregullisht, i mbështetur mbi sistemin manual të mbajtjes të kontabilitetit, si dhe ata të informatizuar të cilat mundësojnë jo vetëm rregjistrimin e të dhënave por dhe marrjen e informacionit, respekton të gjitha kërkesat e Planit Kontabël, ligjin mbi Kontabilitetin dhe kërkesat e tjera ligjore. Llogaritë e ushtrimit financiar të vitit 2022 janë hartuar me hipotezën e vijueshmërisë dhe janë zbatuar vlerësimet e parashikuara në këtë situatë.

Monedha në të cilën shprehen të gjitha pasqyrat financiare është leku shqiptar pa bërë rrumbullakime.

VLERËSIMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Efikasiteti i kontrollit të brendshëm është i lidhur me sigurimin e mbrojtjes së pasurisë nga çdo lloj dëmtimi e shpërdorimi dhe në të njëjtën kohë të sigurojë besnikërinë e informacionit administrativ, kontabël e financiar duke qenë i besueshëm nga përdoruesit.

Vendimarrja në lidhje me problemin e kontrollit të brendshëm lidhet edhe me përgjegjësinë e zbatimit të objekteve dhe parimeve të kontrollit duke filluar nga përdoruesit.

Vendimarrja në lidhje me problemin e kontrollit të brendshëm lidhet edhe me përgjegjësinë e zbatimit të objekteve dhe parimeve të kontrollit duke filluar nga ndarja e punës, verifikimet dhe deri tek informimet, veprime këto që përgjithësisht në Entitet janë realizuar.

SHËNIME MBI ZËRAT E LLOGARIVE NË PASQYRAT FINANCIARE

AKTIVI

AKTIVET MONETARE

Në këtë pozicion të bilancit janë pasqyruar, aktivet monetare në vlerën **123,269 leke**, përcaktuar në llogaritë në arkë dhe në bankë. Ka vijueshmëri në regjistrimin e dokumentave, përse i takon datave dhe ka dokumenta justifikuese për veprimet e kryera. Diferenca e likuiditeteve për vlerën **44,503 lekë**, e pasqyruar drejt në pasqyrën e fluksit monetar bashkangjitur bilancit, përputhet me pasqyrimin e tyre në aktiv të bilancit.

Gjendja e likuiditeteve më 31.12.2021	78,766 lekë
Gjendja e likuiditeteve më 31.12.2022	123,269 lekë

Diferenca	44,503 leke
-----------	--------------------

AKTIVE TË TJERA FINANCIARE AFATSHKURTËRA

Kërkesa të arkëtueshme në vlerën 13,214,115 lekë ku përfshihen detyrimet e klientëve dhe llogaria 4456 “TVSH e zbritshme”, llogaria 411 “Kliente për mallra, produkte e shërbime”

INVENTARI

Inventari për vlerën 68,062 lekë, ku përfshihen: llog 351 “Mallra grupi 1”

Shpenzime të shtyra në vlerën 58,200 leke nga llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhme”

AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Aktive të tjera afatgjata materiale me vlerë kontabël për vlerën 74,962,229 lekë, ku përfshihen: llogaria 20802 “HEC-i” dhe llogaria 2818 “Për të tjera AA materiale”.

PASIVI

HUATË E PARAPAGIMEVE

Për vitin ushtrimor 2022 detyrimet në total janë në vlerën **48,622,670 lekë** që në mënyrë analitike janë si më poshtë :

Detyrimet afatshkurtra me vlerë totale 39,995,730 lekë, ku përfshihen:

Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit, llogaria 401 “Llogari të pagueshme” në vlerën 36,463,540 lekë

Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në vlerën **2,964,854 lekë**, ku përfshihet: llogaria 421 “Paga dhe shpërblime” dhe llogaria 431 “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore”

Të pagueshme për detyrimet tatimore në vlerën 567,336 lekë,

Detyrime afatgjata ne 48,622,670 leke ku perfshihet dhe 451 “Financim Hidro Kons Studio”

KAPITALI

Gjendja e llogarive te Kapitalit dhe Rezervave të Shoqërisë në përfundim të periudhës është në vleren **(192,526) leke** dhe përbëhet nga Kapitali i nënshkruar për **100,000 lekë**, Humbja e mbartur ne vleren **(2,114,933) leke** dhe Fitimi i vitit ushtrimor 2022, marrë nga PASH, me vlerë **1,822,407 lekë**.

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Për vitin 2022 Shoqëria “HIDRO VIZION” SHPK ka realizuar shpenzime në masën **12,293,042 lekë** nga veprimtaria e shfrytëzimit. Shpenzimet janë si më poshtë:

Shpenzime të tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit 2,255,862 lekë ku përfshihen, llogaria 611 “Trajtime te pergjithshme”, llogaria 618 “,llogaria 638 “Tatime te tjera” , llogaria 657 “Gjoba dhe dëmshpërblime“,6271 “Transporte per blerje” llogaria 634 “Taksa dhe tarifa vendore” .

Paga në vlerën 3,861,894 lekë ku perfshihet 641 “Pagat dhe shpërblimet e personelit”

Shpenzimet e sigurimeve shoqërore për 625,005 lekë ku përfshihet llog 644 “ Sigurimet shoqerore dhe shendetësore”.

Shpenzime konsumi dhe amortizimi ne vleren 5,019,168 leke nga llogaria 6862 “per AQ afatgjate”.

Shpenzimet financiare ne vleren 54,526 leke përfshijnë: Llogaria 628 “Sherbime bankare”

Shpenzime e tatimit mbi fitimin ne 379,834 leke nga llogaria 694 “Tatime mbi fitimet”.

MBI TË ARDHURAT

Shoqëria ka realizuar të ardhura në masën **14,115,450 lekë** nga veprimtaria e shfrytëzimit ku përfshihet:

Llogaria 704 “ Shitje e punimeve dhe e sherbimeve” në vlerën 14,115,450 lekë.

PËRLLOGARITJA E TATIM FITIMIT

FITIM/(HUMBJA) E USHTRIMIT	2,202,242
SHPENZIME TE PANJOHURA	329,988
TATIM FITIMI (5%).	379,834
FITIM/(HUMBJA) TATIMORE	1,822,408

PASQYRA E FLUKSIT TË PARAVE-Metoda Indirekte

Eshtë ndërtuar nga ana e jonë në përputhje me standartet kombëtare të kontabilitetit, bazuar në levizjet e mjeteve monetare të shoqërisë sipas kërkesave që ka vetë pasqyra dhe në perfundim rezulton:

Gjendja e likuiditeteve më 31.12.2021	78,766 lekë
Gjendja e likuiditeteve më 31.12.2022	123,269 lekë
Diferenca	44,502 leke

Pra, ka përputhje te plote te pasqyres te fluksit monetar dhe gjendjes te aktiveve monetare te vendosura ne aktiv te bilancit.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Eshtë plotësuar sipas kërkesave duke patur parasysh të gjitha ndryshimet e kryera midis dy periudhave ushtrimore dhe ku gjëndja e këtyre kapitaleve të vet shoqërisë në fund të periudhës paraqitet me një vlerë prej (192,525) lekë cila paraqitet si në pasqyrën e ndryshimit të kapitaleve, po ashtu edhe në postin e kapitaleve në pasiv të bilancit 2022.

SHËNIME TË TJERA SHPJEGUESE

Ngjarje të tjera të ndodhura pas datës të bilancit për të cilat bëhen rregullime apo ngjarje të ndodhura pas datës të bilancit që nuk bëhen rregullime, nuk ka.

Duke patur parasysh shënimet e mësipërme, paraqitim të gjitha aspektet, të gjendjes financiare të shoqërisë deri më 31.12.2022.

Tiranë , më 29.03.2023

Ekonomisti

Isidore Lulaj
KM Consulting
L 02221025 T

Administratori

Daniel Shuaipi

Daniel Shuaipi
HIDRO VIZION Shpk
L618030200
Hec-Razdoli